



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN

RAPORT INDIVIDUAL PËR KONSULTIMIN PUBLIK

1. Titulli i projektaktit

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Në kuadër të respektimit të parimit të transparencës dhe Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, paketa e plotë: strategji, plan veprimi dhe pasaporta e treguesve të performancës 2024-2030, (në vijim: SNKK 2024-2030), iu nënshtrua procesit të konsultimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga aktorët e interesuar në këtë proces. Draft SNKK 2024-2030 qendroi e publikuar për më shumë se 30 ditë kalendarike, nga data 22.07.2024 deri më 31.08.2024, në RENJK, në përmbushje të afatit ligjor të parashikuar për kohëzgjatjen e konsultimit publik. Megjithatë, pas këtij afati dhe me qëllim rritjen e efektivitetit të procesit të konsultimit publik, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit njoftoi të gjitha palët e interesuara dhe të përfshira në procesin e konsultimit publik se mbetet i hapur dhe mirëpret çdo kontribut shtesë apo mbajtjen e takimeve të dedikuara deri më datë 15.09.2024.

Në përfundim të procesit të konsultimit përmbajtja e draft strategjisë nuk ka ndryshuar në strukturë dhe koncept, por janë shtuar dhe riformuluar masa, saktësuar afatet e zbatimit të masave të planit të veprimit, rishikuar të dhëna në pjesën narrative të teksit si dhe plotësuar kostimi i detajuar.

3. Metoda e konsultimit

Strategjia së bashku me aktet e saj shoqëruese (aneksi 1 dhe 2) u hartuan përmes një procesi planifikimi, duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve të ekzekutivit në nivel qendror dhe vendor, institucione të pavarura kushtetuese me kompetenca në parandalimin e korrupsionit, organe të pushtetit gjyqësor, Organizatat e Shoqërisë Civile, sektori privat me dhomat e biznesit dhe shoqatat, dhe me partnerët ndërkombëtarë, veprimtaria e të cilëve mbetet aktive në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent. Përgatitja e paketës së plotë strategjike 2024-2030, është kryer në bashkëpunim të ngushtë me mbështetjen teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, fillimisht të projektit: Asistenca Teknike për Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit (viti 2022) dhe në vijim procesi u mbështet deri në finalizim nga projekti EU4GG (tetor 2023 – shtator 2024).

Për konsultimin e paketës është ndjekur gjithashtu edhe rruga elektronike me dërgimin e sugjerimeve nëpërmjet email-it (1), zhvillimi i tryezave të diskutimit me grupe interesi (2), si dhe njoftimi i publikimit për mundësinë e konsultimit të draftit në RENJK, në profilet sociale të Ministrit për Administratën

Publike dhe Antikorrupsionin, njëherazi Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit (3).

Aktivitetet e realizuara për diskutimin dhe konsultimin e draft SNKK, 2024-2030, përgjatë gjithë kohës:

- 14 Korrik 2022: Takim promovimi dhe njoftim i hartimit të draft SNKK nga Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit. Publikohet struktura qendrore e SNKK dhe koncept idea për objektivet specifike në prani të institucioneve publike me kompetenca të parandalimit të korrupsionit dhe OSHC të fushës.
- 25 Korrik 2022 - 5 gusht 2022: 10 takime teknike (ditore) me institucionet për diskutimin e treguesve të performanceës dhe projekti i parë i planit të veprimit.
- 10 Tetor 2022: Diskutim i SNKK në takimin e Grupit Tematik Antikorrupsion.
- 17 Janar 2023: Takim me OSHC për draftin e rishikuar të SNKK dhe Planit të Veprimit; përfshirja e tyre.
- 17 Nëntor 2023: Tryezë e përbashkët me biznesin dhe partner/anëtarë të tyre, promovimi i objektivit specifik: Integriteti në sektorin privat
- 4 & 7 Dhjetor 2023: Workshop me Transparency International Hollandë dhe Forumi për integritetin në biznes (Java e Integritetit); prezantohet SNKK.
- 23 Maj 2024: Grupi Tematik Antikorrupsion (prezantohet SNKK, paketë e plotë).
- 11 – 14 Qershor 2024: Takime teknike për draftin e plotë të SNKK me institucionet zbatuese (masat dhe treguesit e performancës).
- 22 – 25 Korrik 2024: takime konsultimi të hapura (forume ditore) drejtuar nga Ministri për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit, me 4 grupe interesi: autoritetet publike, si institucionet zbatuese të aktit strategjik; sektori privat dhe dhomat e tregtisë, së bashku me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit; OSHC – media – universitete; të gjitha bashkitë së bashku me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor.

4. Palët e interesit të përfshira

Paketa e SNKK 2024-2030, është hartuar dhe koordinuar nga Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit (në vitet 2022-2023, asokohe Ministri i Drejtësisë) dhe prej janar 2024 nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, asistuar ngushtë nga sekretariati teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, me kontributin e Grupit Institucional të Punës (GIP) të ngritur me urdhrin nr.102, datë 23.3.2022, të Ministrit të Drejtësisë, “Për ngritjen e Grupit Institucional të Punës “Për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe të Planit të Veprimit”. Përmes mbështetjes së asistencës teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë u lehtësua puna e GIP në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri tek kostimi dhe përgatitja e pasaportës së treguesve. Mbështetje dhe kontribut në hartimin e SNKK 2024-2030 kanë pasur gjithashtu:

- Institucionet e pavarura: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës, Struktura e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, ente rregullatore.

- Të gjitha Ministritë e Linjës, si institucionet politikëbërëse në nivel qendror.
- Institucionet e tjera të përfshira: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Trajtimin të Pronës, Agjencia e Prokurimit Publik, Agjencia e Administrimit të Paurive të Sukestruara dhe Konfiskuara dhe varësi të ML-ve, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore, Departamenti i Administratës Publike, Policia e Shtetit, Agjencia e Mbikqyrjes Policore, të gjitha bashkitë.
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)/ Kryeministria.

Njëkohësisht, kontribut kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit dhe aktorë të tjerë në nivel qendror, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare që punojnë me çështje të luftës kundër korrupsionit, dhoma dhe shoqata të biznesit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gjatë periudhës së konsultimit publik të aktit, projekt Strategjia Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, ka marrë gjithsej **42 komente dhe propozime**, nga të cilat **34 janë pranuar** dhe **8 refuzuar**. Këto komente kanë ardhur nga 17 subjekte, ndër to: autoritete publike të pavarura dhe kushtetuese si: KDIMDP; autoritete të sistemit gjyqësor si: Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Komente kanë dhënë OSHC dhe sektori privat (biznese) si dhe 5 janë marrë direkt edhe nëpërmjet RENJK. Në përfundim të periudhës së konsultimit RENJK ka shënuar 969 shikime në total.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Komenti lidhet me tekstin e SNKK.	KDIMDP sugjeron të përfshihet koncepti “<i>transparencë</i>” në përmbajtje të qëllimit të parë të politikës: “Politika e parë synon konsolidimin dhe zhvillimin e instrumenteve dhe mekanizmave të parandalimit të korrupsionit, duke promovuar integritetin, <i>transparencën</i> dhe etikën përgjatë të gjitha hallkave të qeverisjes, si në nivel qendror ashtu edhe vendor”.	KDIMDP	Pranuar	Është shtuar fjala “ <i>transparencë</i> ” në faqen në tekstit e SNKK. Konkretisht, në paragrafin e 4-t, ku prezantohet qëllimi i parë i politikës.

Komenti lidhet me tekstin e SNKK.	KDIMDP kërkon të përfshihet emërtimi dhe akronimi i institucionit, në listën e shkurtesave, i cili duhet të jetë: KDIMDP- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.	KDIMDP	Pranuar	Akronimi KDIMDP është shtuar dhe bërë pjesë e listës së shkurtimeve.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Aktiviteti 1.1.3.4 <i>Identifikimi i institucioneve në të gjitha nivelet, ku nuk janë emëruar (mungojnë) koordinatorët antikorruption, pikat e kontaktit kundër korrupsionit, koordinatorët e integritetit dhe koordinatorët e së drejtës për informim.</i>	KDIMDP saktëson që emërimi i Koordinatorëve për të Drejtën e Informimit bëhet nga titullarët e institucioneve dhe KDIMDP monitoron procesin e informon të dhënat për ta. KDIMDP mund të ketë rol institucioni përgjegjës.	KDIMDP	Pranuar	Aktiviteti 1.1.3.4 qartëson plotësisht rolin e KDIMDP për të evidentuar institucionet që nuk kanë koordinatorë të drejtës për informim, me anë të procesit të monitorimit. KDIMDP do të monitorojë, mbledh dhe gjenerojë informacion lidhur me zbatueshmërinë e këtij procesi nga ana e institucioneve.

Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Aktiviteti 1.1.3.5 <i>Emërimi i koordinatorëve antikorrupsion, të pikave të kontaktit antikorrupsion, të koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim.</i>	KDIMDP saktëson rolin kontribues të tij në zbatimin e aktivitetit sepse caktimi i koordinatorëve është detyrim ligjor i autoriteteve publike (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 119/204, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar). Shkelja e këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative nga ana e titullarit të AP.	KDIMDP	Pranuar	Eshtë zhvendosur KDIMDP në kolonën e institucioneve kontribues të planit të veprimit, për zbatimin e këtij aktiviteti. Aktiviteti 1.1.3.5 e vendos KDIMDP si institucion kontributor në zbatimin e aktivitetit.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Aktiviteti 1.2.1.3 <i>Raport vlerësimi për numrin e institucioneve që publikojnë raporte/analiza vjetore të punës dhe kategorinë e informacionit që ato përmbajnë.</i>	KDIMDP vlerëson se mund të bëjë monitorimin e publikimit të raporteve vjetore por pasi të jetë hartuar formati i ri i tyre dhe kërkon të shihet roli i tij në zbatimin e aktivitetit.	KDIMDP	Pranuar	Ky aktivitet do të parashikohet në Planin e Veprimit që do të hatohet në vitin 2026. Ky koment do të mbahet në konsideratë dhe do të vlerësohet gjatë hartimit të planit pasardhës.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Aktiviteti 1.2.1.3, si më lart.	KDIMDP sugjeron të shtyhet afati për realizimin e aktivitetit pasi analiza/vlerësimi mbi numrin e institucioneve që kanë raporte vjetore, do të jetë puna më voluminoze.	KMDIMP	Pranuar	Afati i zbatimit në aktivitetin 1.2.1.3 është shtyrë për në vitin 2026.

Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Aktiviteti 1.2.1.4 <i>Unifikimi i formatit të raportit/analizës vjetore të punës për institucionet në përputhje me standardet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur - OGP (Format model)</i>	KDIMDP kërkon ndryshimin e rolit të institucionit nga përgjegjës në kontributor sepse, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk ka kapacitetet e nevojshme për hartimi i formatit unifikues të raporteve vjetore të institucioneve (template).	KDIMDP	Pranuar	Ky aktivitet do të parashikohet në Planin e Veprimit që do të hatohet në vitin 2026. Ky koment do të mbahet në konsideratë dhe do të vlerësohet gjatë hartimit të planit pasardhës.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Aktiviteti 1.2.4.1 parashikon hartimin dhe miratimin e planeve të integritetit për prokuroritë dhe gjykatat.	Prokuroria e Përgjithshme sugjeron riformulimin e aktivitetit pasi nuk është relevante për sistemin e prokurorisë. Për më tepër, lidhur me prokurorët, ata i nënshtrohen rregullave të Kodit të Etikës, miratuar nga KLP i cili ndër të tjera synon të vendosë, ruajë dhe forcojë, integritetin profesional dhe personal të prokurorëve.	Prokuroria e Përgjithshme	Pranuar	Në referencë të kuadrit rregullator, u rivlerësua parashikimi i këtij aktiviteti në Planin e Veprimit, duke reflektuar ndryshimet e nevojshme.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Masa 2.2.1 dhe Aktivitetet 2.2.1.1 – 2.2.1.3	Prokuroria e Përgjithshme sugjeron të jetë në rolin e kontributorit në të tre aktivitetet (2.2.1.1 – 2.2.1.3) nën masën 2.2.1	Prokuroria e Përgjithshme	Pranuar	Në aktivitetet 2.2.1.1, 2.2.1.2 dhe 2.2.1.3, Prokuroria e Përgjithshme është vendosur në rolin e institucionit kontributor në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

<i>Dokument (analizë) vlerësimi për zbatueshmërinë e kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e hetimit penal, duke adresuar kërkesat dhe rekomandimet e BE.</i> <i>Identifikimi i ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë nevojë për përmirësim, planifikimi i tyre për miratim</i> <i>Përgatitja e ndryshimeve për të përmirësuar kuadrin legjislativ për hetimin e gjyqësor të korrupsionit, dokumentit analizë në aktivitetin 2.2.1.1</i>				
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Aktiviteti 2.2.2.4 <i>Trajnime të specializuara me pjesëmarrje ndër-institucionale (agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit) për të siguruar veprimtari proaktive mbi hetimin financiar, ndjekjen penale dhe gjykimin e korrupsionit në tema</i>	Prokuroria e Përgjithshme sugjeron të jetë institucion kontributor në aktivitetin 2.2.2.4	Prokuroria e Përgjithshme	Pranuar	Lidhur me këtë koment, sqarohet se është rishikuar roli i Prokurorisë së Përgjithshme si kontribues, duke reflektuar ndryshimet e nevojshme në aktivitetin 2.2.2.4.

si: prokurimi publik, partneriteti publik-privat, koncesionet, pronësia përfituese, pastrimi i parave, etj.				
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Aktiviteti 2.2.3.1 <i>Analizë vlerësimi të burimeve njerëzore, tekniko-profesionale dhe financiare të Prokurorisë së Posaçme (SPAK), të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, të Gjykatës Speciale dhe agjencive ligjzbatuese, për hetimin dhe gjykimin e korrupsionit (si pjesë përbërëse e analizës së efikasitetit për këto organe)</i>	Prokuroria e Përgjithshme sugjeron që të përdoret togfjalëshi “<i>të juridiksionit të përgjithshëm</i>” për këtë aktivitet Masat e PV referuar forcimit të kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale, duhet të shprehen edhe për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm (riformulim), në mënyrë që PP të jetë institucion kryesor.	Prokuroria e Përgjithshme	Pranuar	U shtua koncepti “<i>juridiksion i përgjithshëm</i>” në përmbajtjen e aktivitetit 2.2.3.1. Me formulimin e mëparshëm Prokuroria e Përgjithshme ishte insitucion përgjegjës në këtë aktivitet, por në përmbajtjen e aktivitetit nuk reflektohej juridiksioni i përgjithshëm penal. Tashmë kjo është adresuar sipas komentit të përcjellë nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Aktiviteti 2.2.3.2 <i>Identifikimi i nevojave për ekspertizë teknike për stafet dhe profesionistët e organeve të</i>	Prokuroria e Përgjithshme sugjeron të vendoset institucion kontributor në aktivitetin që parashikon nevoja për ekspertizë teknike.	Prokuroria e Përgjithshme	Pranuar	Në aktivitetin 2.2.3.2 Prokuroria e Përgjithshme është institucio kontributor në zbatim të aktivitetit të parashikuar.

<i>hetimit dhe ndjekjes penale (prokuroritë) dhe të gjyqimit (gjyqësorit) (Plan i miratuar për ekspertizë dhe rritje performance) (vjetor).</i>				
Komenti lidhet me planin e veprimt, 2024-2026. Aktiviteti 2.2.4.1 <i>Forcimi i qasjes proaktive në zbulimin e korrupsionit duke përdorur raportet e mediave, analizën e raporteve të auditimit, gjetjet e inspektimeve dhe bashkëpunimin me koordinatort kundër korrupsionit (raste hetimesh inicuar kryesisht).</i>	Prokuroria e Përgjithshme sugjeron të vendoset institucion kontributor në aktivitet.	Prokuroria e Përgjithshme	Refuzuar	Lidhur me këtë koment, bazuar në kompetencat dhe tagrat institucional të Prokurorisë së Përgjithshme, roli i saj është të kontribuojë në mënyrë proaktive me qëllim identifikimin dhe ndjekjen e rasteve korruptive kryesisht, brenda juridiksionit të saj. Për këtë qëllim, roli i Prokurorisë së Përgjithshme në zbatimin e këtij aktivitetit mbetet kryesor dhe jo kontributor.
Komenti lidhet me planin e veprimt, 2024-2026. Masa 2.3.3 <i>Ngritja e kapaciteteve, shkëmbimi i informacionit dhe aktivitete të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit</i>	Prokuroria e Përgjithshme sugjeron të mos jetë institucion përgjegjës në aktivitetet që i referohen: <i>shkëmbimi i informacionit dhe aktivitete të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke thënë se: PP nuk është strukturë që</i>	Prokuroria e Përgjithshme	Refuzuar	Lidhur me këtë koment, sqarohet se roli i Prokurorisë së Përgjithshme është të referojë vetëm ato raste bashkëpunimi dhe pjesëmarrje të prokurorëve në rrjetet e tyre profesionale (për shkëmbim eksperience dhe ekspertize me Interpol dhe Europol). Njëkohësisht, theksojmë gjithashtu se Prokuroria e Përgjithshme tanimë e ka

<i>ndërkombëtar në fushën e luftës kundër korrupsionit.</i>	<i>bashkëpunon me Interpol dhe Europol.</i>			marrë përsipër këtë detyrim, në zbatim të parashikimeve të Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës. Për këtë arsye, Prokuroria e Përgjithshme do të vijojë të mbetet institucion përgjegjës brenda organizimi dhe juridiksionit të saj, në zbatim të këtij aktiviteti.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026 Aktiviteti 1.2.4.1 parashikon hartimin dhe miratimin e planeve të integritetit për prokuroritë dhe gjykatat.	KL Gj sugjeron aktivitet për miratim plani veprimi për parandalimin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë.	KL Gj	Refuzuar	Lidhur me këtë koment, sqarohet se çështjet që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë, mund të trajtohen në Strategjinë Ndësektorale të Drejtësisë.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026, për parashikimin e një mase të re në objektivin 1.3.	ALTRI propozon shtimin e një mase specifike që do të parashikojë përgatitjen e metodologjisë së vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorin publik, si dhe organizimin e trajnimeve për stafin e DPAK.	ALTRI	Pranuar	Lidhur me këtë koment, u shtua masa e cila parashikon metodologji konkrete për vlerësimin e riskut në sektorin publik dhe dy aktivitete në zbatim të saj. Konkretisht, shtuar masa 1.3.1, dhe dy aktivitete 1.3.1.1 dhe 1.3.1.2, në Planin e Veprimit, si përkatësisht:

				1.3.1.1: <i>Rishikimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik, dhe</i> 1.3.1.2: <i>Organizimi i trajnimeve me koordinatoret kundër korrupsionit dhe punonjës/stafin e DPA për zbatimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik</i>
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026, për saktësimin e aktiviteteve të një mase në objektivin 3.3	ALTRI propozon riformulim të aktiviteteve 3.3.2.1 – 3.3.2.3 lidhur me ngritjen e: <i>Koalicioni Bashkëpunimi të Hapur Kundër Korrupsionit midis KKKK dhe Rrjetit Kombëtar të OSHC-ve Kundër Korrupsionit si dhe OSHC-ve të tjera aktive të fushës, si edhe ngritja e platformës digjitale për të dhe manualët e përdorimit të platformës.</i>	ALTRI	Pranuar	Ky koment adresohet në objektivin 3.3 të Planit të Veprimit, si më poshtë: 3.3.2.1: <i>Ngritja e një Koalicioni Bashkëpunimi të Hapur Kundër Korrupsionit midis KKKK dhe Rrjetit Kombëtar të OSHC-ve Kundër Korrupsionit si dhe OSHC-ve të tjera aktive të fushës.</i> 3.3.2.3: <i>Përmirësimi i ndërveprimit midis autoriteteve publike dhe OSHC-ve mbështetur tek parimet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP).</i>
Komenti lidhet me parashikimet në SNKK dhe në planin e veprimit, 2024-2026, referuar	AIS propozon që pjesë e sektorëve me risk korrupsioni (sektorë vulnerabël) të shtohen edhe	Albanian Institute of Science AIS	Pranuar	Lidhur me këtë koment, theksojmë se sektorët të rinj të propozuar me risk korrupsioni janë pjesë e SNKK (objektivi specifik 1.3).

sektorëve me risk korrupsioni (vulnerabël) për shtimin e tyre.	administrimi dhe drejtimi i ndërmarrjeve shtetërore.			Masat konkrete për këta sektorë do të parashikohen në planin e dytë të veprimit, në zbatim, për të filluar në vitin 2027, pasi plani i veprimit 2024-2025, është menduar të ketë masat për sektorët (prona-arsim-shëndetësi-tatime-dogana, prokurim publik dhe PPP), të cilat janë në përputhje me parashikimet e bëra në Udhërrëfyesin Shteti i së Drejtës. Ndaj për të mundësuar këtë ndërhyrje konkrete është shtuar masa 1.3.9: <i>Parandalimi i korrupsionit në sektorë të tjerë publikë, të ndjeshëm për ekonominë dhe publikun.</i>
Komenti lidhet me parashikimet në SNKK dhe në planin e veprimit, 2024-2026, referuar planifikimit të lidhjes së pakteve për integritetin, në fushën e prokurimeve publike.	AIS propozon që paktet për integritetin, si mekanizma kontrolli për kontratat e prokurimit publik të aplikohen dhe të rritet bashkëpunimi për to me OSHC (si replikim i eksperiencës së BE në kontrollet e prokurimit publik).	Albanian Institute of Science AIS	Pranuar	Pas vlerësimit të komentit, do të merren masa për adresimin e tij në Planin e Veprimit pasardhës.

Komenti lidhet me përmbajtjen e SNKK.	SCiDEV sugjeron që monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të SNKK të bëhet edhe me pjesëmarrjen e OSHC-ve.	Centre Science and Innovation for Development SCiDEV	Pranuar	Lidhur me komentin sqarojmë se OSHC janë pjesë e vlerësimit të zbatimit të SNKK dhe PV pasi ftohen dhe marrin pjesë në takimet e Ekipit Tematik Antikorrupsion, siç parashikohet në pjesën IV të SNKK-së. Pjesa e IV e tekstit të SNKK parashikon: <i>Zbatimi, Llogaridhënia dhe Koordinimi</i> .
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	SCiDEV sugjeron që SNKK dhe Plani i Veprimit duhet të parashikojë masa konkrete për ndërhyrje dhe incentivat për integritetin në administratë.	Centre Science and Innovation for Development SCiDEV	Refuzuar	Lidhur me komentin, sqarojmë se propozime për incentiva në administratë, si masa konkrete mund të bëhen pjesë e Strategjisë për Reformën në Administratën Publike, e cila po finalizohet gjithashtu dhe do të ketë një objektiv specifik për integritetin. SNKK adreson masat për ndërhyrje në administratëm në kuadër të mekanizmave përgjithësues të fushës dhe do të jetë strategjia e RAP dokumenti që mund të identifikojë masa për ndërhyrje konkrete, sipas komentit.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	SCiDEV sugjeron që SNKK dhe Plani i Veprimit duhet të parashikojë masa konkrete për të identifikuar ndërhyrje në sektorë	Centre Science and Innovation for Development SCiDEV	Pranuar	Këto parashikime janë pjesë e objektivëve 1.3 dhe 1.2 të SNKK, përkatësisht.

	me risk korrupsioni si dhe për të adresuar rritjen e transparencës dhe shërbimeve të digjitalizimit.	SCiDEV		Masa 1.2.1 dhe të gjitha aktivitetet e saj (1.2.1.1-1.2.1.6) parashikojnë forcimin e transparencës së institucioneve publike, në funksion të shërbimeve të shtuara të digjitalizimit.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	SCiDEV sugjeron që SNKK dhe Plani i Veprimit duhet të parashikojë masa konkrete për të përdorur Inteligjencën Artificiale në prokurimin publik.	Centre Science and Innovation for Development SCiDEV	Refuzuar	Lidhur me këtë koment, sqarojmë se këto çështje më specifiku gjejnë parashikim në Strategjinë e Prokurimit Publik.
Komenti lidhet me përmbajtjen e SNKK.	KSHH vlerëson qasjen parandaluese të SNKK dhe parashikimin për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe nevojën për ndërhyrje në të, sa i takon parandalimit të korrupsionit. KSHH vlerëson dhe propozon analizë të kujdesshme të ligjit për sinjalizimin, si instrument antikorrupsioni dhe sugjeron edhe masa ndërgjegjësuese për zbatimin e tij. KSHH i jep gjithashtu rëndësi kontrollit të financave të partive politike dhe mekanizmave të kontrollit të tyre.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Pranuar	Këto janë parashikime konkrete të objektivit 1.1, 1.6 dhe 1.7 të SNKK dhe përbëjnë edhe fokusin dhe rezultatet e pritshme të tyre. Teksti i strategjisë, në pjesën narrative të këtyre objektivave adreson ndërhyrjet e përcjella në koment.

Komenti lidhet me përmbajtjen e SNKK.	KSHH sugjeron për rishikim të parashikimeve të SNKK por në drejtim të kontrolleve dhe ruajtjes së integritetit të subjekteve të drejtësisë, gjyqtarë dhe prokurorë.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Refuzuar	Lidhur me këtë koment, sqarojmë se bazuar në kontekstin e këtij propozimi, ky koment mund të jetë pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, e cila është gjithashtu në proces hartimi dhe pritet të finalizohet së shpejti.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	KSHH sugjeron për përfshirje të opinionin publik dhe i referohet grupit të pensionistëve, për angazhime në masa për veprim.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Pranuar	Angazhimi i këtij grupi siç janë pensionistët, parashikohen të targetohen në masat dhe aktivitetet nën objektivin 3.1 të SNKK.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	KSHH sugjeron analiza të detajuara dhe rishikim të metodologjive për monitorimin e planeve të integritetit, mbështetur në tregues performance.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Pranuar	Pas vlerësimit të komentit, do të merren masa për adresimin e tij në Planin e Veprimit pasardhës.
Komenti lidhet me përmbajtjen e SNKK, në objektivin 3.4.	UN Women adreson disa gabime materiale në tekstin e objektivit 3.4: <i>Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm</i> , që nuk i referohen ndërhyrjeve për këtë çështje.	UN WOMEN	Pranuar	Gabimet materiale janë korrigjuar, respektivisht.

Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	UN Women sugjeron të përfshihen masa dhe aktivitete për gratë, duke marrë në konsideratë rastet e korrupsionit dhe përfaqësimin e ulët të grave në qeveri, biznes, etj.	UN WOMEN	Refuzuar	Ky propozim për masa dhe aktivitete nuk është reflektuar në mënyrë direkte, pasi mendojmë se kapërcen objektivat e përcaktuara në SNKK. SNKK 2024-2030 është hartuar në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030 dhe Plani i Veprimit. Në SNKK parashikohet objektivi specifik 3.4: “Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm”, i cili ka në përmbajtjen e tij 2 masa dhe 3 aktivitete specifike që lidhen me angazhimin dhe forcimin e pjesëmarrjes së grave në drejtim të luftës kundër korrupsionit.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	UN Women ngre çështjen se korrupsioni ndikon mbi gratë, veçanërisht lidhur me aksesin e tyre në drejtësi ndaj dhe sugjeron të SNKK të ketë një ndërhyrje për këtë aspekt.	UN WOMEN	Refuzuar	Ky propozim për masa dhe aktivitete nuk është reflektuar direkt, pasi mendojmë se nuk mund të adreson të tilla ndërhyrje në objektiva të SNKK, duke mos u gjetur në relevancë direkte me të. Sugjerojmë të adresohen në dokumente të tjera strategjike siç mund të jetë SND, e cila është në proces hartimi dhe për tu miratuar.

Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	UN Women adreson shqetësimin se gratë përballen me ekspozim më të madh ndaj korrupsionit në shërbime shoqërore. Për këtë kërkon të parashikohen masa për ndërhyrje me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e korrupsionit të hasura nga gratë (si në sektorin publik, ashtu edhe privat).	UN WOMEN	Pranuar	Adresuar në aktivitetin e masës 3.4.1 që evidentojn bashkëpunimin dhe ndërgjegjësimin për gratë dhe me përfshirjen e tyre. <i>Aktiviteti 3.4.1.1 adreson drejtpërdrejtë sugjerimin e marrë: Tryezë vjetore me pjesëmarrje gratë dhe vajzat mbi rolin e tyre dhe angazhimin në forcimin e integritetit të administratës publike dhe luftën kundër korrupsionit</i>
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	UN Women adreson çështje siç janë dallimet gjinore në perceptime, qëndrime dhe sjellje që lidhen me korrupsionin. Sugjeron veprimtari kundër korrupsionit të qytetareve/qytetarëve, aktivisteve/aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe grave si palë interesi.	UN WOMEN	Pranuar	Adresuar në aktivitetin 3.4.2.1: <i>Veprimtari kundër korrupsionit të qytetareve/qytetarëve, aktivisteve/aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe grupeve të interesit të grave dhe vajzave si pjesë përbërëse e kalendarit të aktiviteteve gjatë "Javës së Integritetit".</i>
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026. Në rastet e sistemit të sinjalizimit të ankesave, kërkohet që të dhënat e marra nga ky proces të	UN Women kërkon të garantohet raportimi me ndjeshmëri gjinore në kuadër të mekanizmave sinjalizues dhe sistemit të ankesave për raportimin e korrupsionit; këto mekanizma duhet të jenë transparente, të	UN WOMEN	Pranuar	Lidhur me mekanizmat e raportimit në përdorim nga gratë ato janë plotësisht të mundura dhe mund të evidentohen lehtësisht, si: Bashkëqeverisja dhe DPAK. Këto mekanizma raportimi evidentohen edhe në SNKK.

jenë të evidentuar në terma gjinorë	pavarura, llogaridhënese, të aksesueshme, të sigurta dhe të thjeshtë në përdorim.			Sa i takon mekanizmave të sinjalizimit, duke qenë se kuadri ligjor i sinjalizimit pritet të rishikohet në vitin 2025, është mundësia e adresimit të rasteve edhe kur sinjalizimi merret nga gra.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	SHPGAZ propozon parashikimin e masave dhe ofron mbështetje (teknike dhe financiare) për takime dhe forume me anëtarët e Shoqatës (gra biznesi, sipërmarrëse, tregtare, artizane, freelance, menaxhere e forma të tjera mikrobiznese familjare), për të rritur ndërgjegjësimin dhe mënyrat e raportimit të rasteve të korrupsionit.	Shoqata Kombëtare e Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare SHPGAZ	Pranuar	Adresuar në aktivitetin 1.9.1.1: “ <i>Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi dhe formalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit midis autoritetit publik përgjegjës për politikën antikorruption dhe dhomave aktive të tregtisë dhe të biznesit (marrëveshje bashkëpunimi/klauzola antikorruption)</i> ”; 1.9.1.2: “ <i>Bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe të biznesit (takime periodike dhe të rregullta), ndarje informacioni, koordinim dhe konsultim iniciativash nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit</i> ”; dhe në aktivitetet e masës 3.3.1, respektivisht: “ <i>Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e sektorit privat në luftën kundër korrupsionit</i> ”.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	ICC Albania mbështet hartimin e SNKK dhe PV, dhe propozon parashikime të bashkëpunimit me sektorin privat duke formalizuar marrëveshje dhe lidhur klauzola antikorruptioni.	ICC ALBANIA	Pranuar	Adresuar në aktivitetin 1.9.1.1, respektivisht: “ <i>Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi dhe formalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit midis autoritetit publik përgjegjës për politikën antikorruption dhe dhomave aktive të</i>

	ICC Albania sugjeron rritjen e integritetit në sektorin privat, duke hartuar dhe dhënë asistencë për kode etike, plane integriteti dhe bashkëpunime në fushën e ndërgjegjësimit.			<i>tregtisë dhe të biznesit (marrëveshje bashkëpunimi/klauzola antikorrupsion”;</i> Aktiviteti 1.9.1.3, respektivisht: “ <i>Kryerja e një vlerësimi mbi risqet e integritetit dhe korrupsionit në sektorin</i> ”; Aktiviteti 1.9.1.4, respektivisht: “ <i>Hartimi i modeleve të Kodeve të Etikës dhe Planeve të Integritetit për kompanitë private si instrumente kundër korrupsionit sipas standardeve ndërkombëtare</i> ”; si dhe bashkëpunimi në kuadër të fushatës së “Javës së Integritetit”, gjithashtu.
Komenti lidhet me planin e veprimit, 2024-2026.	NAREA promovon bashkëpunimin për masa ndërgjegjësimi kundër korrupsionit. Gjithashtu ofron mbështetje në vlerësimin e riskut të korrupsionit në fushën e pronave të paluajtshme.	National Albanian Rea Estate Association NAREA	Pranuar	Propozimi i dhënë gjen vend për bashkëpunim në aktivitetet e masës 3.3.1: <i>Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e sektorit privat në luftën kundër korrupsionit.</i>
Komenti lidhet me përmbajtjen e SNKK dhe me parashikimet në planin e veprimit.	DHTA vlerëson hartimin e SNKK dhe qasjen parandaluese të saj dhe sugjeron mekanizma për matjen e zbatimit të saj.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	Pranuar	Theksojmë se SNKK në Pjesën IV: <i>Zbatimi, llogaridhënia dhe koordinimi i Strategjisë</i> , parashikon raportime të rregullta me baza 6-mujore dhe vjetore, të cilësuar si mekanizma kontrolli të zbatimit të SNKK dhe PV.

	DHTA sugjeron që në çdo rast bashkëpunimi me sektorin privat të paraprihet nga një analizë e hollësishme për identifikimin e problematikave në mënyrë që ndërhyrjet të jenë adekuate. DHTA ngre shqetësimin e mbivendosjes së kompetencave të sinjalizuesve dhe të Koordinatorëve antikorrupsion.			Pranuar bashkërendimi i masave midis KKKK dhe përfaqësuesve të sektorit privat për objektivin 1.9, respektivisht në aktivitetin 1.9.1.3. Këto dallime evidentohen në parashikimet e objektivit specifik 2.1 dhe aktiviteteve të parashikuara nën këtë objektiv, duke identifikuar qartësisht tagrat dhe kompetencat institucionale të DPAK-së dhe ILDKPKI-së, në drejtim të hetimit administrativ të korrupsionit.
Komenti propozon përfshirje të masave konkrete në plan veprimi.	WFD është e angazhuar në thellimin e mekanizmave të vlerësimit të korrupsionit gjatë hartimit të ligjeve, ndaj edhe ofron bashkëpunime dhe parashikime masash për planin e veprimit.	West Foundation for Democracy WFD	Pranuar	Lidhur me këtë koment, sqarojmë se ky sugjerim adresohet në masën 1.1.2, respektivisht, aktiviteti 1.1.2.1: “Metodologji (Manual) për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në ligje (Corruption Proofing of Legislation), për shërbimet e Kuvendit (miratimi i Manualit)”; aktiviteti 1.1.2.2: “Kryerje e vlerësimit sipas Metodologjisë së hartuar në aktivitetin 1.1.2.1, të ligjeve dhe opinione /analiza të hartuara”; dhe aktiviteti 1.1.2.4: “Forcimi i kapaciteteve të stafëve teknike të drejtorive juridike dhe të politikave

				<i>pranë ministrive dhe të shërbimeve të Kuvendit, për procesin e Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion në Legjislacion”.</i>
Komenti lidhet me SNKK dhe planin e veprimit. Propozim për shtim të sektorëve me risk krahas atyre që parashikon SNKK.	OSCE propozon të evidentohen edhe fusha dhe sektorë të tjerë në risk (vulnerabël) si infrastruktura, mjedisi dhe gjithashtu të evidentohet roli i Autoritetit të Konkurencës në bashkëpunimin me sektorin privat.	OSCE	Pranuar	Lidhur me këtë koment, theksojmë se sektorët të rinj të propozuar me risk korrupsioni janë pjesë e SNKK (objektivi specifik 1.3). Masat konkrete për këta sektorë do të parashikohen në planin e dytë të veprimit, në zbatim, për të filluar në vitin 2027, pasi plani i veprimit 2024-2025, është menduar të ketë masat për sektorët (prona-arsim-shëndetësi-tatime-dogana, prokurim publik dhe PPP), të cilat janë në përputhje me parashikimet e bëra në Udhërrëfyesin Shteti i së Drejtës. Ndaj për të mundësuar këtë ndërhyrje konkrete është shtuar masa 1.3.9: <i>Parandalimi i korrupsionit në sektorë të tjerë publikë, të ndjeshëm për ekonominë dhe publikun.</i>

Komenti lidhet me SNKK dhe planin e veprimit.	Eksperti Osmani sjell në vëmendje zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe kryesisht në sektorin e arsimit duke evidentuar rolin e oficerëve të sigurisë në shkolla si dhe zhvillimin e orëve ndëgjegjëse për sinjalizimin.	Josiba Osmani (Ekspert i Jashtëm i Reformës në Drejtësi)	Pranuar	Të gjitha komentet e përcjella për instrumentin e sinjalizimit mund të vlerësohen dhe bëhen pjesë e rishikimit të kuadrit ligjor për sinjalizimin, të parashikuar në objektivin specifik 1.6.
Komenti lidhet me SNKK dhe Planin e Veprimit.	1. Koment i marrë nga RENJK, ku promovohet bashkëpunimi me agjenci private. 2. Ofron propozime për rishikimin e kuadrit ligjor për sinjalizimin, për vendosjen e shpërblimit financiar për sinjalizuesit dhe kritere dhe rishikim të rolit të tyre.	Regjistri i Konsultimit Publik Agjencia e Trajtimit të Shërbimeve Regjistri i Konsultimit Publik Qytetar Alban K.	Pranuar Pranuar	Adresuar në objektivin 1.9: <i>Promovimi i integritetit në sektorin privat.</i> Aktiviteti 1.9.1.2: <i>Bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe të biznesit (takime periodike dhe të rregullta), ndarje informacioni, koordinim dhe konsultim iniciativash nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit</i> Adresuar në objektivin 1.6: <i>Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit.</i>